

## **AKT THEMELIMI**

---

### **Shoqeria “ProCert” sh.p.k**

Sot më datë 08/01/2025, une i nënshkruari **zngj. Aviola Ngjeliu** shtetas shqiptar, i datelindjes 11/05/1985, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. I55511131N shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**ProCert**” sh.p.k si më poshtë vijon:

#### **1. FORMA LIGJORE**

“**ProCert**” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

#### **2. ORTAKET THEMELUES**

Ortak themelues i vetëm i shoqerise është Aviola Ngjeliu.

#### **3. OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**ProCert**” sh.p.k. është “Vleresimin e konformitetit te implementimit te standardeve nderkombetare ISO lidhur me Sisteme te Menaxhimit te Cilesise, Sistemet e Menaxhimit te Perputhshmerise, Sistemet e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore dhe H.A.C.C.P, Sistemet e Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë, Sistemet e Menaxhimit të Energjisë, Ssitemet e Menaxhimit të Vazhdimesisë së Biznesit,”.

Trajnime dhe kualifikime per standartet nderkombetare ISO. Trajnime dhe kualifikime profesionale ne te gjitha fushat dhe sektoret e aktivitetit. Trajnime per sigurine dhe shendetin e punonjesve ne punë sipas legjislacionit shqiptar”.

#### **4. SELIA**

Selia e shoqërisë tregtare “**ProCert**” sh.p.k është në adresën: Tirane Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Ndertesa 6 Hyrja 7 Apartamenti 2 Tirane .

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [aviolabani@yahoo.com](mailto:aviolabani@yahoo.com). Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **5. KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, te ketij nen mund të shkurtohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqerise.

#### **6. KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “ProCert” sh.p.k. është 1,000,000 (një milion) leke i perfaqesuar nga 1 kuotë , vlera nominale e te cilës eshte 1,000,000 (1 milion) leke. Ortaku i vetëm është zoterues i kuotes qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise .

Kuotat jane nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

Kuotat përfaqësojnë të drejtën e një votë.

## 7. ORTAKET

Ortaku i vetëm i ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë “**ProCert**” sh.p.k do te jete znj. **Aviola Ngjeliu**. Administratori emërohet me Vendim të Asamblese se Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me te drejte ripërtëritje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**ProCert**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### THEMELUESI

**Aviola Ngjeliu**

